

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	21.11.2020	01.12.2020	Nr.969/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.11.2020, OE - "Baki-Ing SH.P.K" Prishtinë ka parashtruar ankesën me nr.969/20, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo" LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 120.000,00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "Baki-Ing SH.P.K"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP - Qëllimi
- Neni 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7 i LPP - Barazia në trajtim /jo - diskriminim
- Neni 28 i LPP – Specifikimet teknike
- Neni 56 i LPP - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies së kontratës
- Neni 69 i LPP-se - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 108/A i LPP-së – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Neni 41 i RRUOPP

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë/nuk janë të njëjta

AK ka shkelur nenin 6 dhe 7 të LPP-se leu gjatë vlerësimit të tenderit të OE që e ka shpallur fitues nuk ka aplikuar drejt kërkesat e dosjes së tenderit. Për ta nxjerrë këtë OE si të përgjegjshëm, AK nuk ka aplikuar të gjitha kërkesat siç i kishte përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit edhe përkundër mangësive që ky OE i kishte në ofertën e tij, andaj veprimi i tillë i AK-se perkatesisht komisionit të vlerësimit konsiderohet jo-profesional dhe sipas nenit 7 të LPP-se konsiderohet edhe veprim favorizues. Me saktësisht AK nuk ka aplikuar kërkesat e specifikimeve teknike për pozicionin 2 tek Lot 1.

Kjo tregon se AK nuk ka bërë trajtim të barabartë të OE, që do të thote se e ka favorizuar OE që e lea shpallur fitues edhe pse tek ley artikull nule e ploteson specifikimin teknik nga Dosja e Tenderit perkatesisht Aueksi 1.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Baki-Ing SH.P.K" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo" LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121, iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.



AK me këtë veprim ka shkele dhe nenin 6 te LPP-se mbi shfrytëzimin e parasë publike ne mënyrë efikase, efektive, ekonomike dhe vetëm për qëllimin e lendes sepse është duke tentuar ta shpërblej me kontrate një OE te papërgjegjshëm. Sikur ta dinim se AK do ta pranoj kete elektromotor me fuqi 40W, edhe ne do te ofronim çmimin bile edhe me te ulet se sa OE qe AK e ka shpallur fitues per dicka qe nuk mundet ta shfrytëzoj fare.

Bazuar ne këto qe thane me larte, me plot kuptim konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 6 dhe 7 te LPP-se *(me poshtë e gjeni arsyetimin detal mbi mangësitë e ofertës se fituesit qe i ka ne specifikimin teknike..*

AK ka shkelur nenin 28 te LPP-se ~ pasi qe gjate vlerësimit te tenderëve nuk ka respektuar kërkesat qe vet i ka vendosur ne dosje te tenderit përkatësisht ne Aneksin 1 te dosjes.

Veprim i AK-se bie ne kundërshtim te plate edhe me praktikat e mira te prokurimit te përcaktuara tek neni 20 i RRUOPP-se i cili nder te tjera thotë:

*Specifikimet teknike janë te kërkesa te obligueshme, te cilat te gjithë tenderët duhet te respektojnë ne mënyrë qe te jene te përgjegjshëm.*

OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar karakteristikat teknike te kërkuara sipas Aneks 1 përkatësisht nuk i ka plotësuar specifikat teknike per pozicionin 2 tek Lot 1. Si pasoje e kësaj dhe për mangësi te tilla AK është dashur ta cilësoj te papërgjegjshëm e jo te anashkaloj kërkesat e veta dhe ta shpalle fitues. Nisur nga kjo konstatohet se AK lea shkelur nenin 28 te LPP-se, Nenin 20 te RRUOPP si dhe nuk lea respektuar as kërkesat e parashtruara nga vete AK-ja ne dosjen e tenderit.

AK ka shkelur nenin 56 te LPP-se pasi qe nuk ka respektuar kërkesat e tij qe tenderët se pari te vlerësohen sipas kriterave te parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe dosje tenderit e me pas te aplikohet kriteri i vlerësimit, Neni 56.1 i LPP.

Bazuar ne ofertën e OE N.T.SH. "MONT ELEKTRO" shihet se AK nuk i ka trajtuar drejt te gjitha dëshmitë e ofruara nga ky OE dhe duke e favorizuar ate si dhe duke mos e vlerësuar sipas kërkesave te dosjes se tenderit, e ka cilësuar si te përgjegjshëm duke e propozuar edhe si fitues. Ky OE ne fakt është i papërgjegjshëm sepse bazuar ne dëshmitë qe i posedon ne ofertën e tij dhe qe ne i keni bashkangjitur Kërkesës për Rishqyrtim, shihet qarte se oferta e ka një mangësi te theksuar ne aspektin e plotësuesmërisë te specifikime teknike. Nga kjo shihet qarte dhe konstatohet se me veprimet e veta AI<..nuk ka respektuar nenin 56 i LPP.

AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se pasi qe gjate vlerësimit nuk i lea respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç ishin përcaktuar paraprakisht. Neni 59.4 i LPP-se shume qarte e përcakton.

Kërkesa e dosjes se tenderit qe kompania e shpallur fituese nga ana e AK-se nuk e ka plotësuar po e paraqesim ne vazhdim.

AK tek pozicioni 2 i Aneksit 1 te DT -se per LOT 1 ka kërkuar nder te tjera qe fuqia e elektromotorit duhet te jete 44 W e qe e lea paraqitur edhe ne foto tek karakteristikat e tije.

Ne këtë rast OE N.T.SH. "MONT ELEKTRO" ka ofruar dëshminë e prodhuesit te elektromotorit qe e ka ofertuar, nga e cila shihet qarte se nuk e plotëson karakteristiken teknike mbi fuqinë e motorit.

Ja dëshmia qe tregon se elektromotori i ofruar nga ky OE nuk e plotëson kërkesën e AK-se sa i përket fuqisë dhe për këtë arsye si dhe duke u bazuar edhe ne dispozitat e LPP-se,



konsiderohet OE i papërgjegjshmen, Ky elektromotor nuk mundet të aplikohet për qëllimin e përcaktuar nga AK sepse nuk e posedon fuqinë e duhur dhe të nevojshme për hapjen dhe mbylljen e ndërprerësit andaj i bie që AK po tenton të blejë diçka që nuk mundet ta shfrytëzojë,

Kjo tregon qartë se AK po e shkele edhe nenin 1 të LPP pasi që parat publike nuk po i shfrytëzon për qëllimin e parapare, Ne vazhdim e gjeni të ilustruar dëshminë nga prodhuesi i elektromotorit që ley OE e ka ofruar ndërsa si të bashkëngjitur kësaj ankese e gjeni komplet dokumentacionin se bashku edhe me dëshmitë tjera.

Pra po shihet nga karakteristikat teknike që elektromotori i ofruar nga OE N.T.SH. "MONT ELEKTRO", fuqinë e ka vetëm 40 W ndërsa AK ka kërkuar që kjo fuqi të jete 44 W. Sipas rregullave për specifikimet teknike duhet që karakteristikat teknike të ofruara nga OE të përshtaten me ato të kërkuarat ose të jene me të avancuara. Ne asnjë rast nuk lejohet që ndonjë karakteristike teknike si në rastin tone që është njëra riga tre komponentët kryesor të elektromotorëve të jete me ulet, pra nuk lejohet që të mos e plotësojë kërkesën e AK-se. Kjo e bënë këtë elektromotor të papërdorshëm për qëllimin e parapare dhe i bie që AK po shpenzon para për diçka që nuk mundet ta fus fare në përdorim aty ku e ka parapare.

Ky elektromotor nuk e ka fuqinë e nevojshme për hapje dhe mbyllje të ndërprerësit dhe nisur nga ky fakt del që edhe ndërprerësi nuk do të jete funksional. Kjo është shumë e rrezikshme sepse në rastet kur ka ndonjë ngarkesë të tepruar në sistemin transmetues senzoret sinjalizojnë motorin për shkyçje të ndërprerësit që të mos dëmtohet diçka në sistem apo që të mos lëndohet ndonjë punëtor, Ky elektromotor me fuqi prej 40W që i bie të jete 10% më e ulët se fuqia e nevojshme prej 44W për hapje dhe mbyllje të ndërprerësit nuk mundet ta mbyll/shkyçë ndërpresin dhe sistemi transmetues do të vazhdojë punën edhe përkundër sinjalit për ndalim.

Kjo shkakton dëmtim të elementeve përcjellëse të sistemit par rrezikon edhe lëndimin e punëtorëve që operojnë në atë sistem. Pra këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me mos mundësi të përdorimit të elektromotorit dhe ndërprerësit, por kemi të bëjmë edhe me rrezikim të jetëve të punëtorëve që operojnë në këtë sistem. AK nuk u mjaftuaka me kaq sa që me rastin e rishqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim na refuzon si të pa-bazuar pretendimin tone se elektromotori me fuqi 40W nuk e plotëson kërkesën e AK-se sepse sipas aneksit 1, Icy elektromotor duhet të jete 44W,

Është shumë qesharake deklarimi nga anëtarët e komisionit vlerësues për faktin se 2/3 e komisionit janë me profesion adekuat nga inxhinieria elektroteknike dhe që fuqinë e elektromotorit prej 4W me të vogël se sa është fuqia e nevojshme për hapje dhe mbyllje të ndërprerësit, e quajnë si diçka që nuk përbën ndryshim.

Po ashtu spekulojnë për gjoja se kjo është tolerance e lejuar teknike që nuk ndikon aspak në funksionalitetin e elektromotorit. Si mundet një profesioniste të deklarojë këtë kur dihet saktë se ndërprerësit ku do të montohet ky elektromotor i novitet gjithsesi fuqia prej 44W që të mund të hapet dhe mbyllet.

Komisioni i vlerësimit e ka vënë në lajthitje Zyrtarin Kryesor të Prokurimit (ZKP) ndërsa tani po tentojnë ta vejnë në lajthitje edhe OSHP-ne me deklarata jo të sakta për nga aspekti teknik, vetëm sa për ta mbrojtur rekomandimin e gabuar fillestar që e janë për ZKP-ne.

Pra edhe një herë duam të ju sqarojmë se elektromotori e ka fuqinë me të vogël se sa që është kërkuar dhe me të vogël se sa që është e domosdoshme për ta hapur dhe mbyllur ndërprerësin e rrymës dhe si i tillë është edhe jofunksional. Përpos kësaj e bënë jofunksional edhe ndërprerësin e rrymës e që



me pas rrezikohet shume jetën e punëtorëve që operojnë në atë sisteme ku përdoren këto pajisje.

Mjafton të shikohet tikketa nga fotoja e elektromotorit që vet AK e ka paraqitur në dosjen e tenderit që ka qene kërkesë decidive nga ku shihet se nuk ka tolerance tek fuqia e elektromotorit leu edhe kërkohet që kjo fuqi të jete fiks 44W. Shiko foton me poshtë por shiko edhe specifikimin teknik tek Aneksi 1 i DT –se.

Nga kjo po shihet qarte se ley OE nuk është i përgjegjshëm dhe veprimi i AK-se përkatësisht i Komisionit të Vlerësimit bie plotësisht ndesh me nenin 59 të LPP-se por edhe me nenin 41 të RRUOPP-se që flasin ekskluzivisht për vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve bazuar vetëm në kërkesat e parashtruara paraprakisht në dosjen e tenderit.

Ky komision ka shkelur edhe nenin 108/A gjatë trajtimit të kërkesës tone për rishqyrtim sepse ka aplikuar standarde jo të sakta shkencore dhe teknike vetëm sa për ta mbrojtur rekomandimin e vet fillestar.

Kjo është rreptësisht e ndaluar me LPP sepse të njëjtit kanë të nënshkruar deklarate nën betim ndërsa me sjelljen e tyre veprojnë komplet në kundërshtim me LPP-ne, por edhe tentojnë ta ndryshojnë kërkesën e njësisë kërkuese si dhe tentojnë të i shmangen fakteve shkencore me deklarata komplet joprofesionale. Në presim nga OSHP që ta angazhojë në ekspert nga fusha e inxhinierisë elektroteknike që ta bëjë një ekspertizë të bazuar plotësisht në faktet shkencore dhe teknike si të bazuar edhe në kërkesat fillestare të AK-se që i ka vendosur tek dosja e tenderit.

Pas kësaj këtyre që sqaruam më lartë nuk kemi se si të mendojmë ndryshe përpos që të mendojmë dhe pretendojmë se AK ka shkelur nenin 28, 56, 59 dhe 108/A të LPP-se si dhe nenin 41 të RRUOPP-se me rastin e vlerësimit të tenderëve,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-se sepse si pasoje e mos vlerësimit real të ofertave sipas kërkesave të dosjes së tenderit, asaj që kërkon neni 6, neni 7, neni 28, neni 56 dhe neni 59 i LPP-se, del që të jete shkelur apo mos respektuar fare edhe neni 60 i LPP-se. Me që OE N.T.SH. "MONT ELEKTRO" po del të jete teknikisht i papërgjegjshëm atëherë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët në fakt jemi në OE BAK-JNG SH.P.K. dhe mos shpallja fitues e kompanisë tone, AK-ne e ka shtyrë drejt shkelës së plote të nenit 60 të LPP që tregon se tenderi duhet t'i epet OE të përgjegjshmen që renditet j pari për nga cenimi me të ulët.

Kjo është në kundërshtim të plote edhe me kërkesën e LPP-se për shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe efektive pasi që nuk është respektuar kriteri bazë i vlerësimit të tenderit i përgjegjshmen me çmimin me të ulët dhe definitivisht vërtetohet se AK lea shkel nenin 60 të LPP-se.

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-se sepse nuk lea respektuar kërkesat e nenit në fjalë e sidomos ato tek pika 69.2.2 dhe 69.2.4 për e ofruar nga OE i shpallur fitues tek pozicionit 2 i Lot 1. Në këtë nën shume qarte tregohet se për rastet e tilla të procedurave të furnizimit OE duhet të ofrojnë dokumente autentike të prodhuesit me përshkrim të karakteristikave edhe certifikata të hartuara nga institute zyrtare për kontroll të cilësisë.

Me vetë faktin që në dokumentin autentik të prodhuesit tregohet se karakteristikat teknike të elektromotorit nuk plotësohen, del që AK nuk i ka respektuar kërkesat e vendosura në përputhje me këtë nën andaj me plot kuptim mundemi të konstatojmë se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-se me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve,

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë që OSHP do ta shqyrtoj me



kujdes ankesën tone kundër vendimit të Ak-se dhe njeherit do ta aprovoj si të bazuar. Ne kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtonit të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe argumenteve të ofruara nga ne si dhe atyre që i posedon në lenden e kësaj procedure, të merr:

#### VENDIM

APROVOHET e bazuar ankesa e OE "BAK-ING SHPK" lidhur me tenderin "Furnizimi dhe montimi me ndërprerësi të fuqisë dhe pjesë për trafo - LOT 1", i iniciuar nga KEK. dhe lënda të ne Rivlerësim.

Rivlerësimi plotësisht duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike të Aneksit 1 e që realisht me pas do duhej që FITUES të shpallej OE BAK-ING SHPK.

#### KRITERET PËR VLERËSIM

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

OE ankues pretendon se OE fitues nuk ka plotësuar kushtin në specifikim teknike për fuqinë e elektromotorit i cili është kërkuar 44 kw ndërsa OE fitues ka ofruar 40 KW

#### RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

OE ankues është vlerësuar si tenderues i pa suksesshëm.

#### INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marrë ekspertit shqyrtues informacion shtese.

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është palë e interesit në këtë aktivitet të prokurimit.

#### VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim të më hershem për këtë aktivitet të prokurimit.

#### ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e më hershme.



## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Baki-Ing SH.P.K”

### Përgjigje në Pretendimin nr.1


Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka bere shkele te nenit 1, 6, 7, 28, 56, 59, 60, 69 dhe 108/A te LPP-se sepse ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit te dhënë ne specifikimin teknik për fuqinë e elektromotorit që është kërkuar 44 KW, kurse është ofruar prej 40 kw. Ky elektromotor nuk e ka fuqinë e nevojshme për hapje dhe mbyllje te ndërprerësit dhe nisur nga ky fakt del qe edhe ndërprerësi nuk do te jete funksional, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ka rekomanduar për kontrate operatorin ekonomik i cili ka ofruar elektromotorin me fuçi 40 kw qe është për 4 kw me i vogël se elektromotori i dhënë ne specifikim teknik i cili qe ka qene me fuçi 44 kw. Te dy elektromotorët janë te njëjtit tip **Pg 6325-30/44-RL**.

Elektromotori i ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate me parametrat përkatës është ne vijim.

Type: **Pg 6325-30/44-RL**


- Voltage	110 V DC
- Current	0,60 A
- Number of rotations	3000 rpm
- Power	40 W



Ndërsa ne figurën e me poshtme është elektromotori i kërkuar me specifikim te dosjes se tenderit.

Elektromotor rezervë (tipi: **Pg 6325-30/44-RL** ose ekuivalent) për përgatitjen për operim të ndërprerësit

• Tensioni	110 V DC
• Fuqia	44 W
• Rryma	0,60 A
• Numri i rrotullimeve	3000 rpm



Ndryshimi i vetëm është te fuqia e elektromotorit. Te gjithë parametrat e tjerë janë te njëjtë. Psh te dy elektromotorët kane numër te njëjtin te rrotullimeve prej 3000 rrot/min. Autoriteti kontraktues respektivisht komisioni vlerësues këtë ndryshim te fuqisë se elektromotorit prej 4 kw e ka vlerësuar **si te pa ndikim ne funksionalitetin e elektromotorit dhe si tolerance e lejuar teknike**. Meqenëse autoriteti kontraktues ka personel te mjaftueshëm me kualifikime dhe njohuri adekuate ne këtë fushe te cilët kane edhe përvojën përkatëse ne funksionimin e këtyre pajisjeve dhe kane ardhur ne një përfundime te tillë, andaj edhe eksperti shqyrtues ndanë mendim te njëjtë.

Devijime te vogla te cilat nuk ndikojnë ne funksionalitet, nuk janë te larguara substancialisht dhe esencialisht nga ato te kërkuara, janë te lejuara dhe me dispozitat e nenit 59 te LPP-se dhe nenin 41 te RRUOPP . Pra pretendimi se janë shkele nenet e LPP-se te cilët janë paraqitur ne ankese nga OE ankues nuk qëndrojnë. Mbi këtë baze eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te **pa bazuar**.

## MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, rivlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me dispozitat e nenit 59 të LPP-së ka rekomanduar për kontratë oferta e përgjegjshme me çmim më të ultë.

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë është mbi **6800 € më e lirë** se oferta e OE ankues. Pra nga AK është respektuar edhe neni 60 i LPP-së. Nuk ka shkelje të dispozitave të LPP-së të cilat përmenden në ankesë e operatorit ekonomik të cilat do ta dëmtonin procesin e prokurimit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të **refuzohet** si e **pa bazuar**.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi dhe montimi me ndërprerësa të fuqisë dhe pjesë për trafo” LOT 1. me nr. prok. KEK-20-456-121** në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues KEK,
- Panelit Shqyrtues OSHP dhe
- OE ankues “Baki-Ing SH.P.K”